



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1321, datë 28.06.2010

Per

“Publikimin e dokumenteve per keshillim publik rregullore për “Autorizimin e Pergjithshem”, rregullore per “Autorizimin Individual” dhe dokumentin “Per disa shtesa dhe ndryshime ne rregulloren per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike”” .

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës ____06.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori ne shqyrtim relacionin shpjegues te Grupit te punes te ngritur me urdherin nr.571, date 24.05.2010 dhe diskutoi materialin e pergatitur

- Memo e grupit te punes; (**Memoja**)
- Relacioni shpjegues i akteve te propozuara; (**Relacioni**)
- Projektvendim i Keshillit Drejtues; (**Projekt vendimi**)
- Projekt rregullore per “Autorizimin e Pergjithshem”, shoqeruar me Anekset A,B,C; (**Rregullorja**)
- Projekt rregullore per “Autorizimin Individual”, shoqeruar me tre Formularet perkates. (**Rregullorja**)
- Projektakt per disa shtesa dhe ndryshime ne rregulloren “Per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe te serive numerike, shoqeruar me shtojcen 2/1. (**Rregullorja**).

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7, neni 13, neni 66, neni 80, neni 110 te ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Pika 3.10 e “Udhëzues per procedurat e keshillimit me publikun” miratuar me VKD nr. 1183, date 10.3.2010.

3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

KESHILLI DREJTUES:

Nga diskutimi gjate mbledhjes duke iu referuar dhe bazes ligjore te sipercituar,

V Ë R E N :

1. Grupi i punes i ngritur me Urdherin e Kryetarit nr. 571, date 24.05.2010 ka pergatitur dhe paraqitur per shqyrtim ne Keshillin Drejtues projekt -dokumentet rregullatore për “Autorizimin e Pergjithshem”, per “Autorizimin Individual” dhe dokumentin “Per disa shtesa dhe ndryshime ne rregulloren per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike.
2. Projektaktet e pergatitura jane mbeshtetur ne kuadrin ligjor dhe rregullator ne fuqi duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullator te AKEP.
3. Me qëllim qe palet me interes te njihen me keto projektakte te rendesishme rregullatore si dhe te kontribuojne duke paraqitur mendimet dhe komentet e tyre me shkrim mbi to,

PER KETO ARSYE :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114, dhe piken 1 te nenit 115 te ligjit nr. 9918 dhe pikes 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme te AKEP,

V E N D O S I :

1. Të publikoje per keshillim publik dokumentet “Rregullore për “Autorizimin e Pergjithshem”, Rregullore per “Autorizimin Individual” dhe dokumentin “Per disa shtesa dhe ndryshime ne rregulloren per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike””.
2. Afati i keshillimit publik fillon nga data e nxjerrjes se ketij vendimi deri me dt. 31.07.2010
3. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit te AKEP www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi ne daten e miratimit te tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES :

Alketa MUKAVELATI

Benon PALOKA

Ibsen ELEZI

Zamira NURCE

DRAFT PROPOZIME PËR AMENDIME

Në “Rregulloren për Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit miratuar me vendim të Këshillit Drejtues Nr. 932, datë 11.08.2009, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

1. Pika 2 e nenit 3 “Përkufizime” të formulohet si vijon:
 3. **“Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku është origjinuar thirrja.**
2. Pika 22 e nenit 3 “Përkufizime” shfuqizohet.

Neni 2

Pika 5 e nenit 9” Numrat e lëvizshëm”, të formulohet si vijon:

5. **Për cdo operator të një rrjeti kombëtar të lëvizshëm të komunikimeve publike, AKEP do të rezervojë një prefiks të lëvizshëm dyshifror dhe do t’i caktojë serite numerike të këtij diapazoni numerik, vetëm këtij operatori. Për operatorë të tjerë të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike të lëvizshëm, AKEP do të rezervojë një prefiks me tri shifra. Operatorët nuk kanë nevojë të argumentojnë kërkesën e tyre kur aplikojnë për një bllok numrash brenda prefiksit dhe diapazonit të numrave që është rezervuar për ta.**

Neni 3

Të zvendësohen:

1. Në nenin 25 fjala "Article" me "Neni"
2. Në pikën 3 e Nenit 26 kapitulli “2” me "II".
3. Në pikën 5 e Nenit 27 hiqet një "të".

Neni 4

Pika 1 e nenit 28 “Objekti” të formulohet si më poshtë:

- “1. Aplikimi për caktimin e drejtpërdrejtë ose caktimin në procesin e alokimit paresor mund të paraqitet nga operatorët e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike për kategorinë respektive të numrave sic përshkruhet në Kapitullin II të kësaj rregulloreje. Aplikimet mund të paraqiten me shkrim, nëpërmjet postës elektronike ose faksit, por vetëm në adresën e AKEP, email-in ose numrin e faksit të publikuar nga AKEP për qëllimin e administrimit të numrave. AKEP vendos për miratimin apo refuzimin e aplikimit brenda një periudhe 7 ditore ».

Neni 5

Neni 30 “Vendimmarrja” të formulohet si më poshtë:

- 1. Këshilli Drejtues i AKEP cakton:**
 - a. Prefiksin për çdo operator të një rrjeti kombëtar të lëvizshëm të komunikimeve publike.**
 - b. kod të ri kombëtar te destinacionit për një zonë gjeografike të vendndodhjes fikse ose ndryshime te tij.**
 - c. hapjen e një kategorie të re numrash.**
- 2. Kryetari vendos për caktimin e të gjitha kategorive të numrave dhe serive numerike qe nuk përfshihen ne piken 1 të këtij neni.**
- 3. Këshilli Drejtues shqyrton ankimimet lidhur me procedurën e aplikimeve apo refuzimin për caktimin me numra apo seri numerike.**

Neni 6

Shtojca 2, Forma e Aplikimit për caktim e numrave, në **Rregulloren për Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit miratuar me vendim te Këshillit Drejtues Nr. 932, datë 11.08.2009**, pas ndryshimeve formulohet sipas Shtojcës 2/1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 7

Ndryshimet e kësaj rregulloreje hyjnë në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen e Internetit te AKEP.



A K E P

ALBANIAN ELECTRONIC AND
POSTAL COMMUNICATION AUTHORITY

FORMULAR APLIKIMI PER CAKTIMIN E NUMRAVE

Dokument N^o: _____

Data: / /

Shenime/Deklarate

1. Bazuar ne Ligjin Nr 9918, date 19.05.2008, Neni 82, Sipermarresit e rrjeteve te komunikimeve elektronike publike dhe te sherbimeve te komunikimeve elektronike publike aplikojne ne AKEP per caktimin e numrave dhe serive numerike.
2. Sipermarresit kane te drejte te caktojne numra apo seri numerike per perdoruesit e tyre fundore, brenda numeracionit te cakruar nga AKEP.
3. Mbajtesi i te drejtes se perdorimit te numrave te cakruar nga AKEP duhet te zbatoje kushtet per perdorimin e numrave ne perputhje me Nenin 83 te Ligjit Nr 9918, date 19.05.2008.
4. Ndryshimi dhe anulimi i vendimeve te AKEP per caktimin e numrave dhe serive numerike behet ne perputhje me Ligjit Nr 9918, date 19.05.2008, respektivisht Neni 84 dhe Neni 85.

Formulari dergohet ne Adresen:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP

Rr. "Reshit Çollaku", No. 43
Kutia Postare: 253/1
Tirane / Albania

Ose plotesohet online ne sitin web, www.akep.al.



FORMULARI I APLIKIMIT PER CAKTIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

- Une/ne operojmë me një rrjet publik të telefonisë fikse ose një shërbim publik të telefonisë fikse dhe aplikoj për seri **numrash gjeografikë** në zonat e mëposhtme gjeografike:

Zona gjeografike		NDC	Aplikimi per		Nevoja e llogaritur për numra në këtë zone për tri vitet e ardhshme	Sasia e numrave te caktuar tashmë në këtë zonë?	Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar në këtë zonë?
BASHKIA	Komuna		Bllloqe 1,000 numrash	Bllloqe 10,000 numrash			



- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim publik të telefonisë së lëvizshme dhe aplikojmë për serite në vazhdim të **numrave te levizshem** :

Kodi i Drejtimit te Rrjetit (NDC)	Treguesi i adreses se regjistrimit te vendndodhjes (HLR)		Diapazoni i Numrit te Pajtimtarit (SN)		
	h ₁	h ₂	Fillimi i numeracionit	Fundi i numeracionit	Bloqe numerike 10.000 numrash Gjithsej

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një **shërbim informacioni** dhe të aplikojmë për numrin **1 1 8** __ (preferohet), **1 1 8** __ (alternative e parë) ose **1 1 8** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për ofruesit të cilëve u është caktuar një numër për shërbimet e informacionit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një numër të ri.

- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim publik të telefonisë dhe aplikojmë për seri numrash të **numrave personalë**:

Aplikimi për blloqe 1000 numra: _____

Blloqet e preferuara të numrave (psh. **700** 11XXX):

Nevoja e përllogaritur për numra personalë në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra personalë janë caktuar tashmë: _____

Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar: _____%



- Unë/ne synojmë që të ofrojmë një shërbim të **numrave të gjelbër** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (psh. **800** 1234):

Nevoja e përllogaritur për numra të gjelbër në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra të gjelbër janë caktuar tashmë: _____

Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar : _____ %

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një shërbim të **kartave telefonike** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **801** 123):

Data e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një shërbim të **numrave blu** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **808** 123):

Nevoja e përllogaritur për numrat blu në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra blu janë caktuar tashmë: _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një **shërbim Dial-up** dhe aplikojmë për numrat në vazhdim:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **717** 123): _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë **një shërbim me vlerë të shtuar** dhe aplikojmë për numrat në vazhdim:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **900** 123):

Nevoja e përllogaritur për shërbim me vlerë të shtuar në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra për shërbimin me vlerë të shtuar janë caktuar tashmë: _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë **një shërbim SMS me vlerë të shtuar** dhe aplikojmë për kodet e shkurtër si më poshtë:

Aplikimi për sa kode individuale të shkurtër: _____

Numrat e preferuar (e.g. **51234**):

Nevoja e përllogaritur për kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar në tri vitet në vazhdim: _____

Sa kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar janë caktuar: _____

Përqindja e përdorimit të kodeve të shkurtër: _____%

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim telefonik publik dhe synojmë të ofrojmë **shërbime të përzgjedhjes së bartësit**. Unë/ne aplikojmë për kodin e përzgjedhjes së bartësit **1 0** __ (I preferuar), **1 0** __ (alternative e parë) or **1 0** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për operatorët që u është caktuar tashmë një kod i përzgjedhjes së bartësit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një kod tjetër.

- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim telefonik publik dhe kemi nevojë për **prefiksin e rrugezimit për portabilitetin e numrit**. Unë/ne aplikojmë për prefiksin e rrugezimit për portabilitetin e numrit **99** __ (I preferuar), **99** __ (alternative e parë) ose **99** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për operatorët që u është caktuar tashmë një prefiksin e rrugezimit për portabilitetin e numrit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një kod tjetër.

Data: _____ / / _____

Nënshkrimi dhe Vula

Vendi: _____

RREGULLORE

Nr. _____, datë _____.2010

PËR AUTORIZIMIN E PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të shkronjave d), p) dhe nj) të nenit 8, nenit 13 e vijues dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Kjo Rregullore, përcakton procedurat dhe kushtet e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të Komunikimeve Elektronike në Republikën e Shqipërisë, nën Regjimin e “Autorizimit të Përgjithshëm”, në zbatim të nenit 13 e në vijim të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Termat e përdorur në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me rregulloret e BE dhe Rregulloret Nderkombetare të Radiokomunikimit në fuqi.
3. Në kuptim të kësaj Rregulloreje, termi “person” do të përdoret për çdo person fizik dhe juridik.

Neni 2 Fusha e Zbatimit

1. Detyrimi për Autorizimin e Përgjithshëm ekziston për të gjithë sipërmarrësit në fushën e komunikimeve elektronike që rregullohen nga dispozitat për shërbimet/rrjetet e komunikimeve elektronike, veç rasteve kur Autorizimi i Përgjithshëm nuk kërkohet, në zbatim të pikës 2 të nenit 13, të Ligjit Nr. 9918.
2. Nëse angazhimi në një aktivitet në fushën e komunikimit elektronik kërkon gjithashtu edhe dhenien e se drejtës për numeracion dhe brez frekuencash paraprakisht, përpara fillimit të këtij aktiviteti, përveç pajisjes me Autorizim të Përgjithshëm, personat e interesuar duhet të

sigurohen për te drejtat e kërkuara te përdorimit te numeracionit dhe frekuencave në fjalë, për përdorimin e tyre ne mënyrë korrekte.

3. Në zbatim të rregullimeve të parashtuara në këtë Rregullore, kushtet e përdorimit të frekuencave që përdoren pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdorin këto frekuenca, bazuar ne faktin se rreziku i interferencave është minimal, janë përcaktuar nga AKEP me Rregulloren në fuqi “Mbi kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual“-miratuar me VKD nr. 1126, datë 08.01.2010.
4. Përfshihen nga detyrimi për Autorizimin e Përgjithshëm personat/subjektet, për shitjen me pakice, për përdoruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në të kundërt, Autorizimi i Përgjithshëm kërkohet për ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik të tretëve, të cilët, pavarësisht faktit se nuk kanë infrastrukturë të komunikimit elektronik të veten, ofrojnë shërbime të komunikimit elektronik, (megjithëse nen emrin e tyre tregtar dhe veç nga shoqëria kryesore), bazuar ne infrastrukturën e personave te tjerë sigurojnë rrjete dhe shërbime te komunikimit elektronik, me te cilët kane kontraktuar.

KREU II

PROCEDURA DHE KUSHTET E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 3

Procedura

1. Për të ofruar rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm (AP), personat që ofrojnë rrjete publike të komunikimit elektronik ose shërbime të komunikimit elektronik për publikun, duhet që të plotësojnë një “Deklaratë Regjistrimi”.
2. Deklarata e Regjistrimit duhet të paraqitet nga personat/subjektet e interesuar pranë AKEP, në përputhje me modelin e Deklaratës së Regjistrimit (DR) të përfshirë në Aneksin A. Në Deklaratën e Regjistrimit, personi/subjekti duhet të plotësojë një ose me shume zëra të aktivitetit që do të ushtrojë, sikurse janë përshkruar ne Aneksin A te këtij dokumenti, dhe duhet të kërkojë regjistrimin e tij në Regjistrin e Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike të administruar nga AKEP, sipas dispozitave të nenit 7 të kësaj rregulloreje.
3. Kur Deklarata e Regjistrimit nuk është e plotë, personi/subjekti nuk regjistrohet në Regjistrin e Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve/Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike. AKEP brenda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi i një Deklarate Regjistrimi jo të plotë, njofton personin/subjektin për nevojën e plotësimit të dokumentacionit te munguar. Personi/subjekti duhet te paraqese Deklaraten e Regjistrimit te plote brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të AKEP. Në përfundim të këtij afati, nëse personi nuk paraqet një Deklaratë Regjistrimi të

4. Personi/subjekti që ka depozituar një Deklaratë Regjistrimi ka të drejtë të ushtrojë aktivitetet në fushën e komunikimeve elektronike në përputhje me përshkrimin që ka bërë në Deklaratën e Regjistrimit.
5. Personi/subjekti që operon sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, ka detyrim të depozitojë në AKEP, një Deklaratë Regjistrimi për shtesë, ndryshim apo mbyllje të aktivitetit për rastet e mëposhtme:
 - (a) kur kërkohet të ofrohen rrjete dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të tjera, përveç atyre të deklaruara në Deklaratën e Regjistrimit fillestar;
 - (b) kur kërkohet të mbyllë një ose disa nga rrjetet dhe / ose shërbimet e komunikimit elektronik të vendosura më parë në Deklaratën e Regjistrimit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
 - (c) nëse bëhet ndonjë ndryshim në detaje të Deklaratës së Regjistrimit. Çdo ndryshim në të dhënat duhet të njoftohet 15 ditë, përpara se të zbatohet.
6. Cilido person i interesuar për të ushtruar aktivitet në fushën e komunikimit elektronik, duhet të plotësojë online Deklaratën e Regjistrimit (Application Form-DR) në sitin web: www.akep.al dhe pasi AKEP konfirmon përputhshmërinë e saj me kërkesat e Ligjit 9918, e depoziton Deklaratën e Regjistrimit së bashku me dokumentacionin shoqëruar formalisht në AKEP.
7. Forma dhe përmbajtja e Deklaratës së Regjistrimit (Application Form-DR) përcaktohet sipas Aneksit A të kësaj Rregulloreje.
8. Personat/subjektet të cilët për të ofruar rrjete/shërbime të komunikimeve elektronike duhet të përdorin burime të kufizuara (frekuenca dhe numeracion), bashkë me Deklaratën e Regjistrimit duhet të paraqesin në AKEP edhe formularin e aplikimit për frekuenca dhe/ose numeracion.

Neni 4

Certifikata Standarte e Lëshuar nga AKEP

1. Bazuar në aplikimin e një personi/subjekti sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, AKEP do të lëshojë një certifikatë standarde për personin/subjektin, brenda 7 ditëve nga depozitimi i Deklaratës së Regjistrimit, i cili do të:
 - (a) vërtetojë se personi/subjekti ka plotësuar një Deklaratë Regjistrimi në formatin e duhur;
 - (b) vërtetojë se personi/subjekti do ofrojë rrjete dhe / ose shërbime të komunikimit elektronik sipas zërave të plotësuar në Deklaratën e Regjistrimit;
 - (c) vërtetojë se personi/subjekti që kërkon të ofrojë rrjete/shërbime të komunikimeve elektronike do të zbatojë Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, të përcaktuara në Aneksin C të kësaj rregulloreje.

për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të subjekteve të sipërpërmendur, bazuar në Autorizimin e Përgjithshëm.

2. Forma dhe përmbajtja e Certifikatës Standarde përcaktohet sipas Aneksit B të kësaj Rregulloreje. Certifikata do të printohet në dy kopje, ekzemplari i parë me të cilin do të pajiset personi/subjekti do të printohet në format A4 me ngjyra dhe ekzemplari i dytë printohet në format A4 të zakonshëm është për arkiv.

Neni 5

Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm

1. Çdo person/subjekt që ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike dhe operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin C të kësaj Rregulloreje.
2. Për shtimin ose për ndryshimin e termave dhe kushteve ekzistuese për ushtrimin aktivitetit në fushën komunikimeve elektronike (ekzistues ose të reja) nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, AKEP ka detyrimin të mbajë një konsultim publik duke ftuar grupet e interesit për të shprehur mendim për masat, kushtet e propozuara. Konsultimi publik zhvillohet bazuar në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi.
3. Çdo person që operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, duhet të bashkëpunojë me AKEP, kurdo që i kërkohet sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe në bazë të rregullimeve të tjera të ligjeve të aplikueshëm, në fuqi. Ndër të tjera, bashkëpunimi duhet të lejojë dhe asistojë AKEP, për kontrollin e zbatimit të kushteve dhe termave të kësaj Rregulloreje, duke depozituar në AKEP të dhënat statistikore të përditësuara dhe hollësi të tjera lidhur me aktivitetet të cilat janë objekt i regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.
4. Termat dhe kushtet që lidhen me Autorizimin e Përgjithshëm përcaktohen nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga Ligji 9918, nga aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP në zbatim të ligjit dhe ato të parashikuara në Aneksin C të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Regjistri i Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve/Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike

1. AKEP administron Regjistrin e Operatoreve dhe të Ofruesve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, ku përfshihet një arkive me Deklaratat e Regjistrimit në përputhje me piken 6, të nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

2. Regjistri i Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve/Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike do të përmbajë këto të dhëna:
 - a. numrin e regjistrimit në *Regjistrin e Rrjeteve dhe Ofruesve të Shërbimeve të Komunikimit Elektronik*;
 - b. emrin dhe adresën e personit/subjektit;
 - c. numrin e identifikimit në taksa (NIPT) ose numrin e regjistrimit në varësi të llojit të biznesit;
 - d. Të dhënat të regjistrimit ligjor të sipërmarrësit;
 - e. formën ligjore të shoqërisë, përfaqësuesin autorizuar ose ligjor në Republikën e Shqipërisë;
 - f. llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që kërkohen të ofrohen;
 - g. të dhënat e plota për personin e kontaktit me AKEP;
 - h. një përshkrim të shkurtër të aktivitetit;
 - i. numrin e referencës (protokollit) dhe datën e plotësimit të Deklaratës së Regjistrimit;
 - j. ndonjë modifikim të mundshëm në regjimin Autorizim dhe Përgjithshëm për subjektin në fjalë;
 - k. data e pritshme e fillimit të aktivitetit;
 - l. data e pritshme e mbylljes së aktivitetit
3. AKEP mund të modifikojë ose të fshijë të dhënat në Regjistrin e Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike kur këto justifikohen në zbatim të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Detyrimi për Dhënie Informacioni

1. Personi/subjekti që operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm është i detyruar të japë të dhëna / informacionin e duhur në AKEP në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”-miratuar me VKD nr. 1214, datë 07.04.2010.
2. Në varësi të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e ligjit 9918 ose/apo në ligje të tjera, personi/subjekti duhet të jap informacionin duke zbatuar afatet dhe detajimet e bëra në kërkesën e AKEP, që duhet të jenë objektive, të saktësuara dhe në zbatim të detyrimeve specifike.

Neni 8

Detyrimet e personit/subjektit

1. Çdo person/subjekt që ofron Rrjete ose Shërbime të Komunikimit Elektronik nuk duhet të tejkalojë deklaratimet e bëra në Deklaratën e Regjistrimit, ose kushtet e përgjithshme, termat

dhe angazhimet për veprimtarinë në fushën e komunikimeve elektronike, sikurse parashikohen në këtë Rregullore dhe në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ose në akte të tjera që mbulojnë kryesisht çështjet rregullatore.

2. Nëse një subjekt që ofron rrjete ose shërbime të komunikimit elektronik nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm nuk vepron në përputhje me kushtet e parashikuara në Autorizimin e Përgjithshëm, AKEP zbaton dispozitat e Kreut XVI, nenit 132 e vijues të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Neni 9

Përfundimi i Aktivitetit të Komunikimeve Elektronike

1. Çdo person/subjekt ka detyrim, plotësimin e Deklaratës së Regjistrimit në zbatim të nenit 4, dhe të njoftojë AKEP-in, 15 ditë përpara, për përfundimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm. Nëse një subjekt është në falimentim ose në likuidim, AKEP duhet të njoftohet brenda 7 ditësh nga shpallja e vendimit të gjykatës apo vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Modeli i Deklaratës së Regjistrimit në Aneksin A, do të përdoret për njoftim, dhe do të behet reflektimi i këtij fakti në numrin përkatës të regjistrimit në Regjistrin e Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike.
2. Nëse një person/subjekt që disponon burime natyrore të fundme ka plotësuar Deklaratën e Regjistrimit për përfundimin e aktivitetit të tij, atëherë AKEP përveç veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, revokon vendimin/et respektive me të cilin/ët i është/janë dhënë të drejtat mbi burimet natyrore të fundme.
3. Nëse një person/subjekt që ka plotësuar Deklaratën e Regjistrimit përfundon aktivitetin e tij si pasojë e bashkimit me një person/subjekt tjetër, ky i fundit është i detyruar të njoftojë përfundimin e ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik nga subjekti i mëparshëm në zbatim të paragrafit të parë të këtij neni. Personi/subjekti ri ka detyrimin të bëjë modifikimet në Deklaratën e Regjistrimit për të shtuar shërbime të tjera përveç atyre të ofruara nga personi/subjekti i mëparshëm, ose të bëjë një Deklaratë Regjistrimi të ri, nëse nuk ka ofruar shërbime të komunikimeve elektronike deri në momentin e bashkimit.
4. Nëse të gjitha aktivitetet e komunikimit elektronik do të mbyllen, pagesat vjetore do të llogariten bazuar në rregullimet ligjore, nënligjore dhe akteve rregullatore në fuqi, deri në ditën e njoftimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 10

Vlefshmëria e Autorizimit të Përgjithshëm

1. Dispozitat mbi rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, parashikojnë se aktiviteti mund të vazhdojë aq kohë sa subjekti deklaron në Deklaratën e Regjistrimit (në dëshirën e vetë personit/subjektit).

2. AKEP mund të vendosë kufizime ose të ndërpresë vlefshmërinë e Autorizimit të Përgjithshëm, bazuar në Vendime të posaçme të arsyetuara, pasi të jetë dëgjuar mendimi i personit/subjektit përkatës, sipas rregullimeve të Ligjit Nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 11 Pagesat

1. Personat/Subjektet që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, brenda afateve ligjore duhet të kryejnë pagesat për AKEP:
 - a. Për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.
 - b. Për caktimin dhe përdorimin e numeracionit dhe radiofrekuencave, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - c. Për financimin e shërbimit universal, sipas përcaktimeve të ligjit.
2. Për caktimin dhe përdorimin e frekuencave personi/subjekti paguan një taksë që përcaktohet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 12 Publikimi

1. Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim duhet të publikohet në faqen e internetit të AKEP, menjëherë.
2. Nga të dhënat e detajuara të përfshira në Regjistrin e Operatoreve dhe Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të komunikimeve elektronike AKEP publikon në faqen e internetit një listë të përditësuar të emrave dhe të adresave të të gjithë personave/subjekteve dhe llojit të rrjetit dhe shërbimit të komunikimit elektronik që ofron.

Neni 13 Dispozita Trazitore

1. Personat/ Subjektet, brenda 90 ditëve nga publikimi i kësaj rregulloreje duhet të dorëzojnë Deklaratën e Regjistrimit në AKEP dhe do të vazhdojnë aktivitetin në përputhje me këtë rregullore.

2. Çdo person/subjekt i angazhuar nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm sipas ligjit nr. 9918/2008, kanë detyrimin që brenda një muaji nga publikimi i kësaj rregulloreje, të informojnë çdo (a) person/subjekt që bashkëpunon me të, të cilët ofrojnë shërbimin “multimedia information”, dhe (b) rishitësit e tyre, dhe të njoftojnë këtë dokument në AKEP, në mënyrë që kush ofron shërbime të komunikimit elektronik me emrin e ndryshëm tregtar të tyre dhe shoqëritë e ndara të plotësojnë Deklaratën e Regjistrimit në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 2 muaj nga ky publikim.

Neni 14 **Shfuqizimi i dispozitave**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje çdo dispozite e përgjithshme ose e veçante që vjen në kundërshtim me këtë Rregullore, ose me pjesë të saj që rregullojnë çështje të ndryshme në mënyrë të ndryshme do të shfuqizohet.
2. Rregullorja “Për Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm” miratuar me Vendimin Nr. 495, datë 19.09.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP, shfuqizohet.

Neni 15 **Hyrja në Fuqi**

Rregullorja do të hyjë në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP-it.



Varianti Pare

ANEKSI A

Formulari i regjistrimit për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm

<input type="checkbox"/> Fillim i shërbimit
<input type="checkbox"/> Shtim shërbimi
<input type="checkbox"/> Heqje shërbimi
<input type="checkbox"/> Ndryshim të të dhënave
<input type="checkbox"/> Mbyllje të aktivitetit

<input type="checkbox"/> Ofrim të shërbimeve dhe rrjeteve publike
<input type="checkbox"/> Lloji i perfitimit
<input type="checkbox"/> Lloji tregëtar
Numri i Regjistrimit ¹ :

I. Forma ligjore e kompanisë

Person juridik:	<input type="checkbox"/> Shoqërite e thjeshta	<input type="checkbox"/> Shoqëri Komandite	<input type="checkbox"/> shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	<input type="checkbox"/> shoqëri anonime
<input type="checkbox"/> Tjetër formë ligjore				
<input type="checkbox"/> Person fizik				

II. Te dhënat e kompanisë

Ila. Person juridik

Emri / Emri i Kronuar	Emër i veçantë
Zyra e regjistrimit (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar, shteti)	NIPT _____ Numer regjistrimi _____ Zyra e taksave _____

Nr .Tel.	_____	Fillimi i aktivitetit :	____ . ____ . ____
FAX	_____	Modifikuar nga :	____ . ____ . ____
E-mail	_____	Mbyllja e aktivitetit :	____ . ____ . ____
Website	_____		

IIb. Person fizik

Emri i plote & Emri i babait	Numri i pasaportës. / data e lëshimit / autoriteti lëshues
adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar, shteti)	NIPT. _____ Zyra e taksave _____

Nr. Tel.	_____	Fillimi i aktivitetit :	____ . ____ . ____
FAX	_____	Modifikuar nga :	____ . ____ . ____
E-mail	_____	Mbyllja e aktivitetit :	____ . ____ . ____
Website	_____		



III Personi përgjegjës për marrëdhëniet me AKEP

Mbiemri	
Emri	
Nr. Kartes se Identitetit	
Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

IV Te dhëna te personit te kontaktit (qe do te publikohet ne adresën e internetit te AKEP)

Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

V Përfaqësuesi ligjor (Për t'u plotësuar vetëm nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë)

Mbiemri	
Emri	
Nr. Kartes se Identitetit	
Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

VI Kryetari i Bordit Drejtues (Për t'u plotësuar vetëm nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë – te dhënat e regjistruara te nevojshme për te kontaktuar me AKEP)

Mbiemri	
Emri	
Nr. Kartes se Identitetit	
Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

VII Drejtori Ekzekutiv (Për t'u plotësuar vetëm nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë – te dhënat e regjistruara te nevojshme për te kontaktuar me AKEP)

Mbiemri	
Emri	
Nr. Kartes se Identitetit	
Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

VIII Personi qe ndihmuar personin fizik apo personin juridik (n.q.s formulari është plotësuar nga një person tjetër, i cili nuk është përfaqësuesi ligjor ose i autorizuar i personit fizik apo juridik)

Mbiemri	
Emri	
Nr. Kartes se Identitetit	
Adresa (Rruga, Numer, Qytet, Kodi Postar)	
Nr. Telefoni	
Fax	
E-mail	

Shënimi aktivitetet për të cilat kërkoni Autorizimin
Grupi A. Ofrimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike

A01. Ofrimi i rrjeteve fikse	A0101	Rrjeti publik telefonik fiks	
	A0102	Rrjet fiks për telemetri, telematik, instalim radio	
	A0103	Rrjet fiks me akses pa tela Fixed Wireless Access Network	
	A0104	Rrjet mikrovalor	
	A0105	Rrjet me fibra optike	
	A0106	Dhënia me qera e fibrave të përdorura	
	A0107	Rrjet me tela (përfshirë rrjetin optik)	
	A0108	Te tjera (specifiko)	
	A02. Ofrimi i rrjeteve të lëvizshme	A0201	Rrjet të lëvizshëm 2G
A0202		Rrjet të lëvizshme 3G	
A0203		Rrjet TETRA	
A0204		Rrjet privat me radio të lëvizshme	
A0205		Radio të lëvizshme private (vetëm për kompanitë e taksive)	
A0206		Rrjet i lëvizshëm për telemetri, telematik, instalim radio	
A0207		Teknologji të tjera të rrjetit të lëvizshëm (specifiko)	
A03. Ofrimi i rrjeteve satelitore	A0301	Rrjet satelitor fiks	
	A0302	Rrjet satelitor i lëvizshëm	
	A0303	Te tjera (specifiko)	
A04. Ofrimi i rrjeteve nomadik	A0401	Sistemet transmetim të dhenash me bande të gjera përfshirë Rrjetet radio të zonave lokale (RLANs)	
	A0402	Rrjeti i stacioneve satelitore për grumbullim informacioni (lajme)	
	A0403	Rrjet i stacioneve tokësore për grumbullim informacioni (lajme)	
	A0404	Te tjera (specifiko)	



Shënoni aktivitetet që sigurohen nëpërmjet aksesit të rrjetit fikse, të lëvizshëm, nomadic ose satelitor, për të cilat keni kërkuar Autorizimin:

F	M	N	S
X	X	X	X

Grupi B. Ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike

F	M	N	S
---	---	---	---

B01. Shërbimet e përgjithshme	B0101	Ofrimi i linjave me qera				
	B0102	Dhenia me qera e pjesëve të kapacitetit (bandwidth)				
	B0103	Ofrimi i rrjeteve virtuale private (VPN)				
	B0104	Ofrimi i aksesit me bande të gjera				
B02. Shërbimet e transmetimit të të dhënave	B0201	Transmetim të dhënash				
	B0202	SMS (Short Messaging Service) / MMS (Multimedia Messaging Service)				
	B0203	Transmetim i të dhënave me vlerë të shtuar				
	B0204	Ofrim i shërbimit telemetri-telematik-instalim radio				
	B0205	Shërbim për identifikimin e vendndodhjes për anijet në fatkeqësi				
B03. Shërbime të thirrjeve radio	B0301	Transmetimi njëdrejtësh i lajmeve				
B04. Shërbimet e informacionit multimedial	B0401	Audiotext				
	B0402	Videotext				
	B0403	SMS me vlerë të shtuar / MMS me vlerë të shtuar				
B05. Shërbimet e telefonit në fluturim	B0501	Komunikime zeri, të dhënash dhe telefax për pasagjerët në fluturim				
B06. Shërbime të menaxhimit të rrjetit	B0601	Shfrytëzimi i rrjetit për grupe përdoruesish të mbyllur				
	B0602	Ofrimi i portave ndërmjet rrjeteve të ofruesëve të ndryshëm				
B07. Shërbimet internet	B0701	Ofrimi i shërbimit të aksesit të internetit				
B09. Shërbimet e zërit	B0901	Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun				
	B0902	Ofruesit virtual për shërbimin telefonik të disponueshëm për publikun				
	B0903	Shërbimet e zërit nëpërmjet satelitit				
	B0904	Shërbim zeri mbi shërbimet e protokollit internet (VoIP)				
	B0905	Shërbimet e zërit nëpërmjet internetit				
	B0906	Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun në zona të përcaktuara me anë të karatave të parapaguara				
	B0907	Shërbimet Call-back				
	B0908	Shërbimet Call-shop				
	B0909	Ofrimi i telefonave publik me pagesë				
	B0910	Shërbimet e kërkimit të të dhënave në numërorin telefonik				
B10. Shërbime të tjera (përkrahje dhe bashkëngjitur aplikimin)						

Shenime (shkruani komentet tuaja, nese keni)

Paraqitja e detyrimeve ligjore

- Une nepermjet kesaj deklaroj se dua te angazhohem ne aktivitetet e komunikimeve elektornike te shenuara me siper dhe te aplikojte per regjistrim ne regjistrin e ofrueseve te rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike te AKEP.
- Une nepermjet kesaj deklaroj se kam mbyllur aktivitetet e komunikimeve elektornike te shenuara me siper.
- Une nepermjet kesaj deklaroj se kam mbyllur cdo aktivitet te komunikimeve elektronike nen regjimin e Autorizimit te pergjithem.
- Une nepermjet kesaj deklaroj se te dhenat e mia kane pesuar ndryshime, sikurse pershkruhen ne formular.
- Une nepermjet kesaj deklaroj se kam ndryshuar formen ligjore te kompanise sime sic pershkruhet ne formular. Emri i vjeter eshte si me poshte:

Une nepermjet kesaj paraqes ne AKEP te gjithe dokumentacionin e nevojshem ligjor dhe/ose te gjithe dokumentat qe sigurojne se nenshkruesi i kesaj Deklarate Regjistrimi ka lidhje me personin perfaqesues.

Une deklaroj se informacioni qe perfshihet ne deklarimin e paraqitur, sikurse cdo informacion tjeter shoqerues , eshte i sakte dhe i vertete , dhe jam plotesisht i vetedijshem per faktin qe, lidhur me angazhimin ne cdo aktivitet te komunikimeve elektronike per te cilin eshte e nevojshme te sigurosh te drejten e perdorimit per numeracion dhe frekuenca, te drejta te cilat nuk sigurohen nepermjet kesaj procedure, une duhet te paraqese nje aplikim per te fituar te drejtat e perdorimit te cituara me siper perpara fillimit te ofrimit te sherbimit.

Vendi, Data

Emri/ Firma / Vula e kompanise

SHPJEGIME

- A0101 Rrjeti i komunikimeve elektronike perdoret per ofirimin e sherbimeve telefonike te disponueshme per publikun ne nje zone te percaktuar. Rrjeti suporton kapacitete te transmetimit te zerit ndermjet pikave fundore te rrjetit, si dhe forma te tjera te komunikimit, si faks dhe transmetim te dhenash.
- A0103 Rrjet i qendrushem i komunikimeve elektronike nepermjet te cilit i ofrohet perdoruesit fundor akses i pa tela, ku vendi i perdoruesit fundor dhe pika e aksesit te rrjetit jane te qendrushme.
- A0104 Rrjeti i komunikimeve elektronike te qendrushme ne te cilin nyjet jane te lidhura permes linkeve mikrovalore pa tela.
- A0105 Sisteme transmetimi dhe, ne varesi te rasteve, pajisje komutuese ose transmetuese (nga origjina ne destinacion) dhe burime te tjera qe lejojne transmetimin e sinjaleve duke perdorur fibrat optike.
- A0106 Dhenia me qera e fibrave optike te paperdorura ne menyre qe te perdoren per funksionimin e sistemeve te transmetimit dhe, sipas rastit, funksionimin e pajisjeve te komutimit ose rrugesimit (router) dhe burimeve te tjera qe lejojne transmetimin e sinjaleve.
- A0107 Sistemet e transmetimit dhe, sipas rastit, pajisjet e komutimit ose rrugesimit dhe burimet te tjera qe lejojne transmetimin e sinjaleve duke perdorur kablllo metalike ose/dhe kallbo koaksiale.
- A0201 Rrjet publik i levizshem 2 G (GSM/DCS) i cili perfshin te gjitha aftesite e pershkruara ne Rekomandimet mbi Rrjetet e Levizshme 2 G (GSM/DCS) te nxjerra nga ETSI dhe ITU.
- A0202 Rrjet publik i levizshem 3G (IMT -2000), i cili eshte vecanerisht i afte te surportoje sherbimet e reja multimediale, ne shtese te aftesive te rrjeteve 2G si GSM, dhe eshte gjithashtu i afte ne nderthurjen e komponenteve tokesore dhe satelitor.
- A0203 Rrjetet e levizshme publike te cilat jane ne perputhje me Rekomandimet mbi sistemet TETRA (Mobile Digital Terrestrial Trunked Radio Systems), te nxjerra nga ETSI dhe ITU.
- A0204 Cilido rrjet i levizshem qe perdoret per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike nga nje person juridik ose person fizik, me qellim qe t'i sherbeje vetem nevojave te veta profesionale ose qellimeve qe ndiqen nga ai.
- A0205 Rrjetet e lartpermendur jane instaluar, shfrytezuar dhe menaxhuar nga zoteruesit e tyre dhe jane perdorur nga nje numer i kufizuar perdoruesish.
- A0301 Nje rrjet qe perbehet nga stacione tokesore te vendosur ne pika fikse te caktuara, kur perdoren nje ose me shume satelite. Pikat e caktuara duhet te jene pika fikse

te vecanta ose cdo pike fikse e vecante brenda nje zone te vecante.

- A0302 Rrjete qe perfshijne komunikime ndermjet nje ose me shume sateliteve dhe stacioneve tokesor te levizshem.
- A0401 Rrjete lokale radio me bande te gjere (RLAN)
- A0402 Rrjet i perbere nga stacione tokesore (SNG) te sherbimeve fikse satelitore te cilet jane te percaktuar per perdorim ne pikat fikse brenda nje zone gjeografike te percaktuar.
- A0403 Rrjet i perbere nga stacione tokesore te transportueshme te grumbullimit te informacionit (lajmeve), A network comprising transportable Earth News Gathering Stations (ENGs).
- B0101 Telekomunikacion jane facilitetet te cilat sigurojne transmetim te dukshem te kapacitetit ndermjet pikave fundore te rrjetit dhe ato nuk sigurojne aftesine e komutimit me perzgjedhje (funksionet e komutimit te cilat perdoruesit mund t'i kontrollojne si pjese te ofrimit te linjave me qera).
- B0102 Dhenia me qera e nje pjese te kapacitetit te linjave te telekomunikacionit per publikun permes infrastruktures se rrjetit e cila zoterohet dhe/ose menaxhohet e gjitha ose pjeserisht nga personi qe ka njoftuar.
- B0103 Rrjetet private virtuale (VPN) qe i ofrohen publikut, permes infrastruktures se rrjetit e cila zoterohet dhe/ose menaxhohet e gjitha ose pjeserisht nga personi qe ka njoftuar. Rrjeti privat virtual eshte pjese e rrjetit te perbashket qe siguron sherbimet e rrjetit duke perdorur infrastrukture te perbashket komutimi.
- B0202 Sherbim i mesazheve te shkurter (SMS) dhe sherbim i mesazheve multimediale (MMS).
- B0301 Transmetim i sinjaleve analoge dhe dixhitale, te cilat dergojne sekuencat e zerit ose karaktereve alfanumerike ne marresit e levizshem.
- B0401-Ofrimi i infrastruktures teknike per gjetjen e informacionit dhe programeve
B0403 argetuese nepermjet nje numri aksesi te vecante (perfshire thirrjet ne kodet e shkurter ose numrat e serive 901, 909) ose nepermjet transmetimit/ marrjes se mesazheve.
- B0501 Komunikime zeri, te dhenash, telefax per pasagjeret ne ajer ne rrjetet fikse dhe te levizshme mbi bazen e operimit te stacioneve radio tokesore.
- B0601 Shfrytezimi dhe menaxhimi i rrjeteve te telekomunikacionit per grupe te mbyllur perdoruesish, perfshire komutimin e zerit.
- B0602 Ofrimi i portave ndermjet rrjeteve te ofrueseve te ndryshem.
- B0801 Transmetimi i sinjaleve televizive dhe zerit ndermjet ofrueseve radio-televiziv nepermjet transmetimeve te jashtme dhe linjave te shperndarjes si linjave te ndryshimit te programit.

- B0802 Transmetimi i sinjaleve televizive dhe zerit nga stacioni radio apo stacioni televiziv ne rrjetet e shperdarjes se transmetimit.
- B0803 Shperndarja e sinjaleve televizive tek pajtimtaret.
- B0901 Sherbim i disponueshem per publikun per origjinimin dhe marrjen e thirrjeve kombetare dhe nderkombetare dhe aksesin ne sherbimet e emergjences nepermjet nje numri ose numrave qe perfshihen ne planin e numeracionit kombetar ose nderkombetar telefonik.
- B0902 Personi i cili, pavarsisht se nuk ka infrastrukturen e tij te komunikimeve elektronike dhe ne kete menyre nuk ka efekte te interkoneksionit me rrjetet e tjera, siguron sherbime telefonike nen emrin e tij tregetar te ndryshem dhe te ndare nga organizata (kompania) e perbashket - bazuar ne infrastrukturen e personave te tjere qe sigurojne sherbimet dhe/ose rrjetet e komunikimeve elektronike, me te cilet ky person ka nenshkruar kontraten e lidhur.
- B0904 Sherbime zeri qe ofrohen nepermjet protokolleve IP.
- B0907 Ofrimi i lidhjes telefonike nepermjet thirrjes mbrapsht (callback) automatike
- B0908 Ofrimi i thirrjeve telefonike per publikun nepermjet centraleve te telefonave publik.
- B0909 Ofrimi i telefonave publik te instaluar gjithmone ne vende publike te aksesueshem per publikun ne 14 ore baze.



ANEKS A (Varianti dytë)

**DEKLARATË REGJISTRIMI
PER OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHERBIMEVE TE KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

Hyrja në AKEP:
N.º Klientit:
Destinacioni: / /

Drejtoria:
Sektori:
Data / /

<input type="checkbox"/> Fillimi shërbimit	<input type="checkbox"/> Ndryshim te dhenave
<input type="checkbox"/> Shtim shërbimi	<input type="checkbox"/> Mbyllje te aktivitetit
<input type="checkbox"/> Heqje shërbimi	

A. Të dhëna të nevojshme për identifikimin dhe komunikimin me aplikantin/kërkuesin.

Emri/Emri i shoqërisë aplikuese/kërkuese		
Adresa Vendbanimi/Zyra qendrore e aplikantit/kërkuesit:		
Qyteti / Shteti		
Telefon	Fax	E-mail/ Website
Aplikanti/Kërkuesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në:		
Qarku/Rrethi/Qyteti:	Si:(SH.P.K./SH.A. etj.)	
NIPT-i		

Emri i Përfaqësuesit ligjor te kërkuesit/aplikantit:	Numri personal i letërnjoftimit/kartës së identitetit-ID
Adresa	Kutia Postare
Qyteti	Qarku/Rrethi



Telefon	Fax	E-mail

Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Përshkrimi i llojeve të rrjetit ose shërbimeve që aplikuesi do të ofrojë, si dhe koha e fillimit të aktivitetit:

1. Rrjete publike të komunikimeve elektronike: Datë: |_|_|_|_|_|_|
2. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:
- a) Shërbime publike telefonike: Datë: |_|_|_|_|_|_|
- b) Shërbime të linjave me qera: Datë: |_|_|_|_|_|_|
- c) Shërbime të tjera vec telefonisë dhe linjave me qera: Datë: |_|_|_|_|_|_|
3. Rrjete dhe shërbime private të komunikimeve elektronike: Datë: |_|_|_|_|_|_|

Aplikanti/kërkuesi kërkon që t'i lëshohet çertifikata konfirmimit e ofruesit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:

- Po Jo

Aplikanti/kërkuesi bashkëngjit dokumentat e mëposhtem, të cilat janë pjesë e njoftimit:

- a) kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe të certifikatës së regjistrimit në organet tatimore, duke përfshirë edhe NIPT-in;
- b) kopje të aktit të themelimit bashkë me ndryshimet dhe plotësimet e pesuara, dhe kopje të dokumentave që provojnë cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit të përmendur në njoftim;
- c) kopje të leternjoftimit (kartes së identitetit) ID të aplikantit/kërkuesit, nëse ai është person fizik;
- d) përshkrimi teknik për rrjetet dhe shërbimet që kërkon të ofrojë.

Aplikuesi/kërkuesi është dakord që adresa dhe kontaktet e tij të publikohet në Regjistrin Zyrtar të Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike:

- Po



DOSJA E PËRSHKRIMIT PËR RRJETET DHE SHËRBIMET

A. RRJETE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

1. Rrjete publike tokësore fikse

<input type="checkbox"/> Rrjete publike fikse	1.1. Zona e ofrimit ⁽¹⁾		
	1.2. Rrjeti i aksesit	<input type="checkbox"/> Tela metalike	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marre me qira (nga
		<input type="checkbox"/> Kabell koaksiale	<input type="checkbox"/> i veti <input type="checkbox"/> marre me qira (nga
publik, sigurise publike, ose demtimit te planit rregullues te qytetit, pas kerkesave te bera nga ky sipermarres, AKEP mund te detyroje nje ofrues tjeter te rrjeteve publike te komunikimeve elektronike te lejoje perdorimin e perbashket te nje faciliteti specific ose prone te patundshme, duke perfshire edhe vete godinen.

2.1.5. Nderveprimi i sherbimeve dhe Interkoneksioni i Rrjeteve

a) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun ka te drejte te negocioje interkoneksionin dhe te marre akses ose te interkonektohet me sipermarres te tjere qe operojne nen regjimin e Autorizimit te Pergjithshem ne menyre qe te ofroje rrjete te komunikimit elektronik dhe /ose sherbime te disponueshme per publikun.

Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun:

- i. Eshte i detyruar te lejoje operatoret e tjere te rrjeteve publike te komunikimeve elektronike qe punojne nen regjimin e Autorizimit te Pergjithshem te interkonektohen me rrjetin e tij pa shkaktuar asnje vonese, pas plotesimit te aplikimit perkates dhe pas arritjes te marreveshjeve perkatese tregtare dhe teknike.
- ii. Kur ofron akses ose interkoneksion, sipermarresi nuk duhet te imponoje detyrime qe nuk jane te lidhura drejtperdrejt me aksesin dhe sherbimet e interkoneksionit te ofruar.
- iii. Kur merret informacion nga sipermarres te tjere para, gjate, ose pas procedures se negociimit te aksesit dhe/ose interkoneksionit, sipermarresi duhet ta perdore kete informacion vetem per qellimin per te cilin ai eshte dhene dhe duhet te ruaje konfidencialitetin e informacionit qe i eshte dhene. Infomacioni i marre nuk duhet t'ju kalohet paleve te treta, vecanerisht atyre qe ofrojne sherbime te tjera, pasi mund te perfitojne avantazh konkurues nepermjet ketij informacioni.
- iv. Neqoftese ndermjet sipermarresit dhe paleve te tjera te interesuara nuk arrihet marreveshja qe eshte e nevojshme per nje interkoneksion te mjaftueshem dhe efektiv te rrjeteve te komunikimit elektronik ne menyre qe te sigurohet nderveprimi i sherbimeve te komunikimeve elektronike per te gjitha perdoruesit brenda Shqiperise, pales se interesuar i lind e drejta te zbatoje proceduren e zgjidhjes se mos marrveshjeve te parashikuar ne ligjin per komunikimet elektronike.
- v. Duhet te zbatoje plotesisht dispozitat e ligjit per komunikimet elektronike mbi standardet teknike qe jane te pershtatshem per qellimet e interkoneksionit.
- vi. Nuk duhet te silltet ne menyre te papelqyeshme dhe s' duhet te vonoje ne menyre te pajustificuar ofrimin e aksesit ose interkoneksionit, dhe nuk duhet te interferoje ne cfardo menyre me ofrimin e sherbimeve nga rrjetet dhe pajisjet e interkonektuar.

- vii. Duhet te zbatohet detyrimet qe mund t'i vendosen lidhur me cilesine e interkoneksionit.
- viii. Duhet te jape informacion lidhur me pagesat e interkoneksionit kurdohere qe i kerkoet nje gje e tille.
- ix. Kopje e cdo marreveshje interkoneksioni te arritur ndermjet paleve duhet te dorezohet ne AKEP. E njejta gje vlen edhe per cdo refuzim te kerkeses per te dhene interkoneksion. AKEP ka te drejte te kerkoje amendimin ose kufizimin e ketyre marreveshjeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

b) Ne cdo rast, marreveshjet e interkoneksionit dhe aksesit duhet te jene ne perputhje me ligjin mbi konkurrencen dhe vecanerisht me dispozitat lidhur me detyrimet e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg, si dhe duhet te perputhet me cdo instruktim te dhene apo vendim te marre nga AKEP, bazuar ne ligjin per komunikimet elektronike persa i perket ceshtjeve te interkoneksionit.

2.1.6. Standardet – Kerkesat teknike

a) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun duhet te zbatohet standardet dhe kerkesat teknike ne perputhje me aktet ligjore dhe rregulla te tjera ne Republiken e Shqiperise si dhe detyrimet qe rrjedhin nga anetaresia ne organizata nderkombetare.

b) Neqoftese standarde apo kerkesa teknike te tilla nuk jane nxjerre nga Organizatat Europiane te Standardeve, do te aplikohen standardet dhe rekomandimet nderkombetare te miratuar nga Bashkimi Nderkombetar i Telekomunikacioneve (ITU), Organizata Nderkombetare e Standardizimeve (ISO) ose Komisioni Nderkombetar Elektroteknik (IEC).

2.1.7. Publikimi i Nderfaqeve

Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun eshte i detyruar te publikoje specifikimet e nderfaqeve te perdorura per ofrimin e sherbimeve per publikun.

2.1.8. Pajisjet fundore te telekomunikacionit dhe pajisjet radio

a) Gjithe pajisjet fundore te telekomunikacionit dhe pajisjet radio qe perdoren nga nje sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun duhet te jene ne perputhje me dispozitat e rregulloreve per keto lloj pajisjesh, qe nxirren ne perputhje dhe ne zbatim te Direktives 99/5/EC (Direktiva R&TTE).

b) Cdo ofruer eshte i detyruar te marre te gjitha masat e nevojshme ne menyre qe te siguroje se ne rrjet do te lidhen vetem pajisje fundore telekomunikacioni qe jane ligjerisht te disponueshme ne treg duke perfshire, ne varesi te rastit, kushtet qe lidhen me vendosjen e kabllit ne facilitetet e abonentit dhe vendndodhjen e pikes fundore te rrjetit. Ai eshte gjithashtu i detyruar te lejoje lidhjen pa asnje vonese te pajisjeve te te gjitha llojeve me

origjine prodhuese apo tregtare, me kusht qe ato te plotesojne kerkesat e vendosura ne kete paragraf dhe te jene ligjerisht te disponueshme ne treg.

c) Nje ofruesi nuk i lejohet te vendose asnje kusht teknik shtese pervec atyre te parashikuara ne standardet dhe/ose specifikimet perkatese qe kane te bejne me pajisjet fundore te telekomunikacioneve, ose te beje diskriminim ne trajtimin e pajtimtareve, me kusht qe pajisjet fundore te telekomunikacioneve qe ata deshirojne te perdorin te jene ligjerisht te disponueshme ne treg.

2.1.9. Cilesia e sherbimeve te ofruara

a) Sipermarresit qe ofrojne rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun jane te detyruar te plotesojne gjithe detyrimet lidhur me cilesine e sherbimeve. Detyrimet lidhur me cilesine e sherbimeve, treguesit e se ciles jane percaktuar ne rregulloret e AKEP.

b) Sipermarresit qe ofrojne rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun jane te detyruar te publikojne informacion krahasues, te mjaftueshem dhe te perdituesuar lidhur me cilesine e sherbimeve qe i ofrohen perdoruesve fundore.

2.1.10. Detyrimi per Dhenie Informacioni

a) Cilido sipermarres eshte i detyruar t'i jape AKEP-it cdo informacion te kerkuar qe i lejon ketij te fundit te vleresojte pajtueshmerine e sipermarresit me kushtet e Autorizimit te Pergjithshem. Pervec kesaj, sipermarresit jane te detyruar t'i japin AKEP-it akses ne librat e llogarive dhe informacionit te perdituesuar financiar, statistikor, teknik dhe te tarifave, qe kane lidhje me kushtet e Autorizimit te Pergjithshem, kur kerkohet nje gje e tille. Detyrimi i mesiperme nuk ka te beje me te dhenat personale te perdoruesve perpunimi i te cilave eshte objekt i ligjit per mbrojtjen e te dhenave, konfidencialitetit te komunikimeve dhe mbrojtjen e privatesise ne sektorin e komunikimeve elektronike.

b) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun eshte i detyruar t'i dergoje AKEP-it cdo te dhene te kerkuar nga anketimi i perdorur per analizen e tregun dhe perpunimin e statistikave.

2.1.11. Inspektimi

a) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun eshte i detyruar te lejojte AKEP-in te kontrolloje perputhshmerine e tij me specifikimet perkatese te Sherbimeve Elektronike qe ai ofron.

AKEP, si pjese te detyrave te tij, duhet te kontrolloje informacionet qe merr dhe duhet te inspektojte facilitetet dhe funksionet e rrjeteve te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbimeve ne menyre qe ofruesit e rrjeteve te komunikimeve elektronike dhe sherbimeve te

jene ne perputhje me specifikimet e aplikueshme. Sipermarresit duhet te lejojne AKEP-in te kete akses ne facilitetet e tij per qellime inspektimi.

Kostot e te gjitha matjeve, thirrjeve ose perdorimit ne pergjithesi te rrjeteve te komunikimeve elektronike dhe sherbimeve qe ofrohen nga nje sipermarres, te cilat jane kryer ne zbatim te dispozitave te ketij paragrafi mbarten nga sipermarresi qe eshte duke u inspektuar.

b) Ne kryerjen e detyrave te veta te inspektimit, AKEP nuk eshte i detyruar te njoftoje ofruesin qe me pare mbi qellimin e tij per te kryer inspektim. AKEP do te organizoje kryerjen e detyrave te veta perkatese ne menyren me te mire per cdo rast ne vecanti.

c) Sidoqofte, AKEP ne pergjithesi i njofton sipermarresit per inspektimin dhe ky njoftim mund te pershkruaje qellimin e inspektimit, facilitetet qe do te inspektohen, daten dhe kohen e inspektimit, si dhe cdo informacion dhe dokumentacion te shkruar qe ofruesi duhet te beje te disponueshem gjate inspektimit. Sipermarresi duhet te bashkepusoje me AKEP per kryerjen e inspektimit ne menyre sa me te mire, duke pergatitur dhe paraqitur dokumentacionin dhe informacionin e kerkuar, me kusht qe ai te kete informacionin e lartpermendur. Perpara fillimit te inspektimit, inspektoret e AKEP-it duhet t'i paraqesin sipermarresit ose perfaqesuesit te tij te autorizuar detaje te identifikimit te tyre se bashku me urdherin per kryerjen e ketij inspektimi specifik, i cili duhet te jete firmosur ne menyren e duhur nga titullari i AKEP-it. Neqoftese ka arsye bindese, te cilat duhet t'i njoftohen AKEP-it, qe e bejne kryerjen e inspektimit te pamundur ne daten dhe kohen e percaktuar ne njoftimin fillestar, me kusht qe arsyetimi te jete pranuar, AKEP dergon nje njoftim tjeter sipas kerkeses se ofruesit, dhe neqoftese inspektimi pengohet per shkak te mosbindjes te sipermarresit, AKEP ka te drejte te ndermarre gjitha veprimet ligjore , duke perfshire edhe vendosjen e sanksioneve administrative ne zbatim te ligjit per komunikimet elektronike.

d) rezultatet e cdo inspektimi duhet te regjistrohen ne nje raport qe pergatitet per kete qellim nga AKEP dhe i njoftohet ofruesit.

2.1.12. Mbrojtja e Konsumatorit

a) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun duhet te zbatoje dispozitat e ligjit lidhur me mbrojtjen e konsumatoreve. Cdo marreveshje qe sjell kufizime apo eliminim te pergjegjesive te sipermarresit konsiderohet e pavlere.

b) Cdo sipermarres eshte i detyruar te zbatoje te gjitha dispozitat e parashikuara ne kontraten lidhur me ofrimin e rrjetit dhe sherbimeve, si dhe ne ligjin per komunikimet elektronike persa i perket te drejtave te Perdoruesve.

c) Sipermarresit jane te detyruar te aplikojne procedura per shqyrtim te menjehershem te kerkesave dhe ankesave te bera nga Perdoruesit lidhur me instalimin, fillimin, perfundimin, faturimin dhe cilesine e rrjeteve publike te komunikimeve elektronike dhe sherbimeve qe i ofrohen publikut. Pervec kesaj, ofruesit jane te detyruar te informojne AKEP, neqoftese kjo gje kerkohet nga AKEP, lidhur me te gjitha kerkesat dhe ankesat e mesiperme te firmosura ne menyren e duhur dhe qe i jane paraqitur ofruesit. Informacioni i mesiperme mund te

perfshije gjithashtu edhe informacionin mbi menyren dhe kohen e plotesimit te ketyre kerkesave.

d) Cilido sipermarres eshte i detyruar qe brenda nje afati kohor te arsyeshem te marre te gjitha masat e nevojshme per te lehtesuar dhe ndihmuar Perdoruesit per zgjidhjen e problemeve qe lidhen me funksionimin e rrjeteve publike te komunikimeve elektronike dhe sherbimeve per publikun.

2.1.13 Kontratat

a) Cdo sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun eshte i detyruar te kete nje tekst standard qe rregullon marredheniet e tij me Perdoruesit. Kushtet e perfshira ne kete tekst standard duhen te jene sa me qarta, te sakta dhe te thjeshta, ne menyre te tille qe Perdoruesit te jene plotesisht te ndergjegjshem per te gjitha kushtet kontraktuale. Ne menyre me specifike, kushtet e pergjthshme duhet te jepen te shkruara ne leter dhe/ose ne format elektronik ne menyre qe te mund te lexohet lehtesisht.

b) Kontratat e sherbimit me Perdoruesit duhet te kene formen e nje Kontrate Aksesit, duhet te jene ne pajtim me dispozitat koresponduese te ligjit per komunikimet elektronike dhe ligjin per mbrojtjen e konsumatorit.

c) Sipermarresi duhet te synoje qe konsumatorit te jene njohur me te gjitha kushtet e kontrates perpara se te nenshkruajne aplikimin e pajtimtarit. Cdo pyetje e mundshme e bere nga konsumatorit lidhur me kushtet kontraktuale duhet te sqarohet nga personeli i ofruesit ose rrjeti i shitesve lokale te autorizuar nga ofruesi.

d) Cdo kontrate per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike per publikun mund te jete me kohe zgjatje te percaktuar ose te papercaktuar. Pajtimtaret duhet te informohen ne kohen e lidhjes se kontrates per penalitetet mbi nderprerjen e kontrates dhe kohe zgjatjen minimale te lidhjes.

e) Nje kontrate e lidhur ndermjet nje pajtimtari dhe nje sipermarresi qe ofron lidhjen dhe/ose aksesin ne rrjetin publik telefonik ose ndermjet nje konsumatori dhe nje ofruesi sherbimesh te komunikimeve elektronike, duhet te perfshije detajet minimale qe vijojne:

- i. Adresen dhe te dhenat e ofertuesit.
- ii. Sherbimet e ofruara, nivelin e cilesise se ketyre sherbimeve, si dhe kohezgjatjen e lidhjes fillestare.
- iii. Natyren e mirembajtjeve qe u behen sherbimeve te ofruara.
- iv. Informacion lidhur me tarifat, si dhe mjetet e perdorura per dhenien e informacionit te perditesuar lidhur me gjithe tarifat e zbatueshme dhe pagesat e mirembajtjes, (shtuar) si dhe periudhen kohore per njoftimin e cdo ndryshimi te tyre.

- v. Kohezgjatjen e kontrates, kushtet e rinovimit dhe perfundimit te sherbimeve dhe te kontrates.
 - vi. Kushtet e zbatueshme per kompensimin dhe rimbursimin neqoftese detyrimet kontraktuale lidhur me cilesine e sherbimit jane shkelur.
 - vii. Procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve. Neqoftese nje mosmarreveshje duhet cuar ne gjyq, gjykata e qytetit ku banon Perdoruesi eshte ajo qe ka juridiksion mbi cdo mosmarreveshje qe lind nga kjo kontrate.
 - viii. Te drejten e Perdoruesit qe komunikimet e tij/saj te ruhen si konfidenciale dhe sekrete.
 - ix. Te drejten e Perdoruesit qe te jete i lire te zgjedhe lidhjen ne piken fundore te nje rrjeti telefonik fiks dhe perdorimin e pajisjes fundore, me kusht qe pajisja e zgjedhur te jete e pershtatshme per t'u lidhur ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne ligj.
 - x. Kerkesa e perdorimit te gjuhes shqipe per cdo sherbim qe kryhet nga sipermarresit qe ofrojne rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime.
 - xi. Proceduratne rast te moskryerjes se pageses apo te kryerjes me vonese te pagesave per sherbimet. (shtuar sipas ligjit).
- f) Neqoftese nje sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun ndryshon kushtet e kontrates ne menyre te njeanshme, atehere pajtimtareve u lind e drejta te perfundojne kontraten pa kosto suplementare brenda 1 (nje) muaji mbas marrjes se njoftimit. Ofruesi eshte i detyruar te njoftoje pajtimtaret, nepermjet shtypit apo me e-mail, mbi ndryshimet dhe te drejten e perfundimit te kontrates, te pakten 1 (nje) muaj perpara se ato te behen efektive.
- g) Pa paragjykuar dispozitat mbi konkurrencen dhe principet e mirebesimit dhe te etikes si dhe ligjin per mbrojtjen e konsumatorit, rritja e tarifave me efekt prapaveprues eshte e ndaluar.

2.1.14. Detyrimet ndaj Perdoruesve

- a) Cilido sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun eshte i detyruar te siguroje teknikisht instalim, funksionim dhe mirembajtje te persosur te sherbimeve te komunikimeve elektronike qe ofron, ne menyre qe te mos rrezikojte jeten, shendetin apo pronen e Perdoruesve te sherbimeve te mesiperme.

- b) Cilido Perdorues ka te drejte te kerkoje nga ofruesi ndreqjen e cdo demi direkt apo indirekt ose demi moral te pesuar si rezultat i nje mirembajtje, instalimi ose funksionimi difektoz te rrjeteve apo sherbimeve te komunikimeve elektronike te ofruara. Nderprerja e pajustificuar e rrjetit dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike qe i jane dhene Perdoruesit krijon te drejten e kompensimit. Nderprerja e kerkuar per kryerjen e punimeve te nevojshme te mirembajtjes, neqoftese i eshte njoftuar paraprakisht Perdoruesit, nuk do te konsiderohet e pajustificuar.
- c) Vecanerisht, neqoftese disponibiliteti i rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike te dhena eshte me i ulet se cilesia e sherbimeve qe kerkohen sipas dispozitave te Autorizimit te Pergjithshem ose ne te drejttat e perdorimit te radio frekuencave ose numeracionit qe i jane caktuar nje sipermarresi, me kusht qe problemi nuk eshte shkaktuar nga pajtimtari, atehere sipermarresi eshte i detyruar t'i kreditoje pajtimtarit pjesen e shumes qe duhet paguar nga ky i fundit qe korespondon me kohen kur sherbimet e komunikimeve elektronike ishin nderprere.
- d) Ofruesi eshte pergjegjes ndaj Perdoruesit per cdo dem lidhur me sherbimet e komunikimeve elektronike qe ai i ofron publikut, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

2.1.15. Forca Madhore

a) Pa kufizuar dispozitat e ketij dokumenti, nje sipermarres qe ofron rrjete publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbime per publikun nuk do te konsiderohet se ka thyer rregullat e parashikuara ne kuadrin e Autorizimit te Pergjithshem ose ne te drejttat e perdorimit te radio frekuencave apo te numeracionit qe i eshte caktuar, si rrjedhim i mos perputhjes me kushtet apo si pasoje e mosplotesimit te kushteve per periudhen kohore kur kjo mos perputhje me kushtet ka ardhur per shkak te nje Force Madhore.

b) Me poshte eshte nje liste e ngjarjeve te Forces Madhore: Lufta (qofte e shpallur apo jo), rebelime, akte te sabotimit, akte terrorizmi, eksplozione dhe zjarre qe nuk kane ardhur si pasoje e neglizhences se qarte nga ana e ofruesit, embargot dhe grevat. Gjate cdo ndodhie qe u permend me siper, ofruesi duhet te marre gjitha masat e arsyeshme ne menyre qe te plotesoje me aq sa mundet kushtet e pershkruara ne kuadrin e Autorizimit te Pergjithshem ose ne te drejttat e perdorimit te radio frekuencave apo numeracionit te caktuar atij ofruesi.

c) Ofruesi eshte i detyruar te siguroje qe ne rast se ndonje fatkeqesi ndodh per shkak te Forces Madhore, te marre te gjitha masat per te ruajtur disponibilitetin e rrjetit publik te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbimeve qe i ofrohen publikut dhe mirembajtjen e nivelit me te larte te mundshem te sherbimeve ne menyre qe t'i pergjigjet kerkesave te vendosura nga cilido Autoritet publik.

2.1.16. Detyrime per Mbrojtjen Kombetare dhe Sigurine Publike

a) Ofruesi i rrjeteve publike te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbimeve per publikun duhet te bashkepusoje me Qeverine e Republikes se Shqiperise lidhur me mbrojtjen kombetare dhe ceshtje te sigurise publike.

b) Ne rastet e gjendjes se jashtezakonshme, ofruesi eshte i detyruar te bashkepunoje me Autoritetet Kompetente dhe te zbatoje ne rast nevoje nje plan emergjence, i cili duhet te percaktoje proceduren e sigurimit te sherbimeve ne zonat ku eshte shpallur gjendja e jashtezakonshme per aq kohe sa eshte ne fuqi kjo gjendje. Pervec kesaj, nje ofrues eshte i detyruar te bashkepunoje dhe te marre pjese, neqoftese kjo gje i kerkohet nga Autoritetet Kompetente, ne perгатitjen e planit te emergjences.

3. Detyrime te Vecanta per Kategori te Sherbimeve Publike

3.1. Detyrime Shtese per Ofrimin e Sherbimeve Telefonike Publike

Dispozitat e perfshira ne kete paragraf permbajne detyrime shtese per sipermarresit qe ofrojne Sherbime Publike Telefonike. Keshtu, cilido sipermarres qe vepron nen regjimin e Autorizimit te Pergjithshem dhe ofron Sherbime Publike Telefonike eshte i detyruar te zbatoje dispozitat e ketij paragrafi.

3.1.1. Sherbimet e emergjences

a) Ofruesit e Sherbimit Publik Telefonik duhet t'ju mundesojne Perdoruesve aksesin ne numrin e emergjences "112", ose numrat e tjere te emergjences te percaktuar ne ligj, pa pagese nga cdo pajisje fundore e pajtimtareve te telekomunikacioneve dhe/ose telefonat publike.

b) Ofruesit e Sherbimit Telefonik Publik jane te detyruar te sigurojne pa pagese gjithë informacionin e nevojshem per identifikimin e vendndodhjes se personit qe ka thirrur autoritetet kompetente ne menyre qe te veprojne me emergjence, per te gjitha thirrjet e bera ne numrin e emergjences "112".

c) Ofruesit e Sherbimit Publik Telefonik qe ofrojne Sherbime te Mesazheve te Shkurta (SMS), ne menyre qe t'u sherbejne personave qe kane probleme serioze me te folurit dhe degjimin, jane te detyruar te sigurojne akses ne sherbimet e emergjences pa pagese nepermjet Sherbimit te Mesazheve te Shkurta (SMS).

3.1.2. Sherbimet e kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik.

a) Ofruesit e Sherbimit Publik Telefonik jane te detyruar, pervec dispozitave te ligjit per mbrojtjen e te dhenave personale:

i. Te pajisin Pajtimtaret e tyre me Numerator Telefonik.

- ii. T'u siguroje Perdoruesve me akses te pakten nje sherbim te kerkimit te informacionit ne Numeratorin Telefonik i cili mbulon te gjithe numrat e pajtimtareve te regjistruar ne telefonine zanore ose fikse dhe komunikimin personal. Neqoftese sherbimi i kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik eshte pjese e Sherbimit Universal, atehere ofruesit e sherbimit te telefonise zanore jane te detyruar t'ju sigurojne Pajtimtareve akses ne te pakten nje sherbim te kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik si pjese e Sherbimit Universal.
- iii. T'ju siguroje Perdoruesve te te gjithe telefonave te tyre publike, ne se kjo eshte teknikisht e mundur, akses ne sherbimet e informacionit qe sigurohen nepermjet serive 118XX.

b) Gjithe ofruesit e Sherbimit Publik Telefonik qe caktojne numra telefonike jane te detyruar te informojne pajtimtaret e tyre, mbas lidhjes se kontrates perkatese, duke perfshire dhe pajtimtaret me karte te parapaguar te telefonise se levizshme, per (a) qellimet e numeratorit telefonik te shtypur ose ne forme elektronike qe i shperndahen publikut ose mund te merren nepermjet sherbimeve te informacionit; (b) te drejten e tyre per t'u perfshire ne numeroret telefonike te disponueshem per publikun; dhe (c) te drejten e tyre te kontrollojne dhe ne se eshte e nevojshme te korigjojne ose te kerkojne fshirjen e te dhenave te tyre nga numeratori. Nje pajtimtar ka te drejte t'i kerkoje operatorit qe i ka caktuar numrin e telefonit ne se te gjitha ose nje pjese e numrave ose te dhenave personale te tij/saj mund te perfshihen ne numeratorin telefonik te disponueshem per publikun, apo ne se nje pjese apo te gjitha te dhenat personale dhe numrat e tij mund te behen te disponueshem per te tretet.

c) Menyra e perdorur nga pajtimtari, per te shprehur deshiren e tij mbi ate nese deshiron te perfshihet ne numeratorin telefonik te operatorit te tij, duhet te jete ne perputhje me kushtet e parashikuara ne ligj per mbrojtjen e te dhenave personale ne sektorin e komunikimeve elektronike.

d) Ofruesit e sherbimit telefonik publik qe caktojne numra telefonike, perpara se te transferojne detaje te pajtimtareve te tyre tek te tretet, jane te detyruar te informojne pajtimtaret e tyre pa pagese ne se kjo eshte e mundur, si dhe per personin qe do te marre apo kategorine e atyre qe mund te marrin kete informacion, si dhe qellimin e transferimit, i cili nuk mund te jete i ndryshem nga ai per te cilin jane marre keto te dhena per here te pare. Ne kete menyre pajtimtaret kane mundesine te shprehin deshiren e tyre lidhur me kete transferim ashtu sic percaktohet dhe ne ligjin perkates per mbrojtjen e te dhenave personale ne sektorin e komunikimeve elektronike.

e) Pajtimtareve me karte telefonike te parapaguar ju kerkohet te njoftojne deshiren e tyre me shkrim ose ne menyre elektronike tek operatori i tyre, ne se deshirojne te perfshihen ne numeratorin telefonik apo jo.

f) Cdo ofrues i sherbimit telefonik publik qe cakton numra telefonike per pajtimtaret e tij eshte i detyruar te plotesoje cdo kerkese te arsyeshme per sigurimin, brenda kuadrit te ofrimit te numeratorit telefonik dhe informacionit per numrat, e informacionit perkates ne nje forme

te caktuar dhe ne nje rruge qe eshte e qarte, objektive, e paanshme dhe e orientuar ne kosto. Detyrimi i mesiperme ka te beje vecanerisht me kerkesen e sigurimit te sherbimeve te informacionit per numrat dhe/ose nxjerrjen e numeratorit telefonik dhe, pertej ketij qellimi, nuk lejohet asnje akses tjeter ne detajet e Perdoruesve, pa lejen e shprehur te tyre. Ne se lind nje mosmarreveshje ndermjet paleve te interesuara lidhur me sa me siper, cilado pale e interesuar ka te drejte te ankohet prane AKEP dhe te kerkoje nje investigim lidhur me pajtueshmerine me kushtet e percaktuara ne kete paragraf.

g) Ofruesit e sherbimit publik telefonik jane te detyruar te jene te paanshem kur perpunojne dhe paraqesin detajet e Perdoruesve te tyre ose detajet qe u behen te disponueshem atyre nga ofrues te tjere te sherbimit publik telefonik.

h) Ofruesit e sherbimit publik telefonik duhet te negociojne nderveprimin pas kerkeses se bere nga nje ofrues tjeter i sherbimit publik telefonik per te pasur akses ne sherbimet reciproke te informacionit per numrat, brenda kuadrit te informacioneve qe jane te hapura per publikun ne sherbimet e tyre te informacionit per numrat.

i) Sipermarresit jane te detyruar te sigurojne qe aksesit i pajtimtareve te nje rrjeti te komunikimeve elektronike ne sherbimet e kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik, qe sigurohet me kod te shkurter, nepermjet nje rrjeti tjeter te komunikimeve elektronike ose ne sherbimet e siguruara nga i njejti rrjet i komunikimeve elektronike, ne nje zone tjeter gjeografike, mund te realizohet nepermjet kodit te shkurter, pa kerkuar formimin e nje prefiksi te vecante qe i eshte caktuar rrjetit apo zones gjeografike.

j) Ofruesit e sherbimit publik telefonik jane te detyruar te zbatojne instruksionet e dhena nga AKEP lidhur me ceshtjen e sherbimit te kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik.

k) Ofruesit e sherbimit publik telefonik duhet te sigurojne qe ata vete t'i pergjigjen cdo pyetje te bere nga konsumatorit lidhur me cmimin e ngarkuar per thirrjet drejt sherbimit te kerkimit te informacionit ne Numratorin Telefonik, me kode te shkurter, qe sigurohen nepermjet rrjeteve te tyre.

3.1.3. Sherbimet e postes zanore

Ofruesit e sherbimit publik telefonik jane te detyruar te sigurojne akses per cdo perdorues fundor te lidhur nepermjet rrjetit te tyre publik telefonik ne sherbimet e postes zanore.

3.1.4. Kontratat

Cdo kontrate e propozuar nga nje ofrues i sherbimit publik telefonik duhet t'i paraqitet AKEP-it te pakten 2 (dy) muaj perpara se ajo te filloje te zbatohet. Brenda 45 (dyzet e pese) diteve nga paraqitja e kontrates standarde, AKEP mund te kerkoje nga ofruesi amendimin e ndonje kushti kontraktual ose shtimin e ndonje kushti te ri, duke mbajtur parasysht qe ajo

duhet te kete permbajtjen minimale ne perputhje me paragrafin 2.1.13. Neqoftese periudha 45 ditore nga njoftimi ligjor i kontrates kalon pa marre ndonje pergjigje, atehere kontrata konsiderohet e miratuar. Neqoftese ofruesi nuk paraqet kontraten standarde, ose cfaredo amendimi te mundshem te saj ne AKEP, atehere AKEP ka te drejte te vendose sanksione administrative sipas ligjit per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise. Ne cfaredo rasti, AKEP ka te drejte te propozoje nje tekst standard te kontrates.

3.1.5. Perfundimi i sherbimeve

a) Ofruesi i sherbimit publik telefonik ka te drejte te perfundoje, perkohesisht apo perfundimisht, ofrimin e sherbimeve telefonike per nje pajtimtar vetem neqoftese ky i fundit nuk zbaton detyrimet kontraktuale dhe vecanerisht neqoftese pajtimtari ka detyrime financiare te pashlyera ndaj operatorit, si dhe ne rastin e forces madhore.

b) Neqoftese nje Pajtimtar shkel zbatimin e detyrimeve te tij kontraktuale, sepse nuk ka shlyer detyrimet e tij financiare ndaj ofruesit te tij te sherbimit, ofruesi duhet te njoftoje Pajtimtarin, qofte edhe ne faturen e pajtimtarit, per mundesine e perfundimit te perkohshem apo te perhershem dhe mund te procedoje me perfundimin e sherbimeve vetem 15 (pesembedhjete) dite mbas njoftimit te rregullt ligjor qe i eshte bere Pajtimtarit. Nje SMS e derguar per kete qellim nuk konsiderohet si njoftim ligjor. Perfundimi i mesiperme duhet te preke vetem sherbimet specifike per te cilet eshte detyrimi i papaguar, neqoftese kjo gje eshte e mundur teknikisht. Gjate perfundimit te perkohshem dhe neqoftese ai eshte bere vetem per nje sherbim specifik, Pajtimtari duhet te jete i afte te beje thirrjet dalese qe jane pa pagese.

c) Sherbimet mund te perfundohen ne menyre te perhershme, vecanerisht kur ka shuma te papaguara nga pajtimtari per ofruesin, vetem mbasi kane kaluar 60 (gjashtedhjete) dite pas perfundimit te perkohshem te sherbimeve, ose mbasi pajtimtarit i eshte bere nje njoftim i rregullt ligjor. SMS e derguar per kete qellim nuk konsiderohet si njoftim ligjor. Sidoqofte, perfundimi do te mbetet vetem per sherbimet specifike per te cilat eshte detyrimi financiar i papaguar, kur kjo gje eshte e mundur teknikisht. Percaktimet e mesiperme nuk zbatohen ne rastet e mashtrimeve apo parregullsise se perseritur ne pagimin e faturave, ku perfundimi i perhershem aplikohet menjehere dhe pa detyrim per ofruesin per te derguar njoftim paraprak.

3.1.6. Fatura e detajuar

a) Cdo fature e derguar Pajtimtareve nga ofruesi, qe tregon koston e sherbimeve telefonike te kryera, duhet te perfshije nje nivel minimal te fatures se detajuar, sic percaktohet nga ligji. Faturat u dergohen pajtimtareve nga ofruesi i sherbimit, pa pasur nevojen e nje pagese shtese.

b) Pervec kerkesave te ligjit per mbrojtjen e te dhenave personale dhe mbrojtjen e privatesise ne sektorin e telekomunikacioneve, AKEP ka te drejte te percaktoje nivelin e detajeve te fatures qe i dergohet pa pagese konsumatoreve nga ofruesit e Sherbimit Publik Telefonik ne vendndodhje fikse, keshtu qe konsumatoret te jene ne gjendje:

- i. te verifikojne dhe kontrollojne shumat qe i jane ngarkuar per perdorimin e rrjetit publik telefonik ne vendndodhje fikse; dhe
- ii. te monitorojne perdorimin e tyre dhe kostot perkatese ne menyre te pershtatshme, pra te kene nje nivel te arsyeshem kontrolli mbi faturat e tyre.

c) Neqoftese eshte e nevojshme, ka mundesi t'i ofrohen pajtimtareve fatura me me shume elemente te fatures se detajuar parkundrejt nje pagese te arsyeshme apo pa pagese. Cdo thirrje e bere nga nje pajtimtar pa pagese, perfshire thirrjet ne linjat e ndihmes, nuk eshte e nevojshme te perfshihet ne faturen e detajuar te pajtimtarit. Detyrimi per dhenien e nje niveli minimal te detajimit nuk zbatohet neqoftese pajtimtari ka deklaruar ne menyre te shprehur se nuk deshiron te marre nje fature te tille.

3.1.7. Tarifat

a) Pavaresisht nese faturat per Sherbimet Publike Telefonike hartohen mbi bazen e sasise se informacionit te transmetuar apo kohezgjatjes se tij, faturat nuk duhet te mbulojne periudha sherbimi me te gjata se dy muaj.

b) Pajtimtaret nuk duhen faturuar per thirrje te paperfunduara per mos pergjigje te pales se thirrur, as dhe per kohen e harxhuar derisa pala e thirrur te pergjigjet. Neqoftese ka dyshime lidhur me faturat, pajtimtari ankohet me shkrim tek sipermarresi brenda 15 diteve mbas marrjes se fatures. Po ashtu, pajtimtaret kane te drejte qe, ne perputhje me percaktimet ne kontrate per zgjidhjen e mosmarreshjeve, te ankohen ne gjykate.

c) Faturat duhet te tregojne afatin e fundit per pagimin e tyre. Ne cdo rast, nje fature nuk duhet te konsiderohet si e pa paguar ne kohen e duhur deri 30 dite nga data e nxjerrjes se saj, e cila eshte e shkruar ne fature. Sipermarresit duhet te marrin masa qe faturat e nxjerra t'i dergohen pajtimtareve sa me shpejt qe eshte e mundur.

3.1.8. Departamentet e sherbimit te konsumatorit

a) Cdo ofrues i sherbimeve publike telefonike duhet te siguroje ekzistencen e procedurave per shqyrtimin e problemeve qe hasen nga konsumatoret dhe duhet te kete departamentet e sherbimit te konsumatorit ose personel te trajnuar ne menyre te duhur dhe speciale ne pikat e tij te shitjes.

b) Ne bashkepunim edhe me AKEP, ofruesit e sherbimit publik telefonik duhet te bejne nje grupim te problemeve /pyetjeve qe jane drejtuar tek departamenti i sherbimit te konsumatorit nga Perdoruesit dhe duhet te trajnoje personelin e sherbimit te konsumatorit qe te jete i afte te trajtoje efektivisht, ne menyre te standardizuar, te pakten ceshtjet e ndeshura me shpesh te perfshira ne cilendo kategori.

c) Nder te tjera, ofruesit e sherbimit publik telefonik duhet t'i sherbejne perdoruesit lidhur me ceshtjet e difekteve nepermjet nje linje speciale pa pagese e cila te punoje te pakten 12 ore ne dite, nga e Hena deri te Shtune.

3.1.9 Transparenca dhe publikimi i informacionit

Sipermarresit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të publikojnë informacion të saktë, të qartë dhe të përditesuar lidhur me tarifën e tyre dhe kushtet për akses dhe përdorim të rrjetit të tyre publik telefonik nga Përdoruesit Fundorë.

a) Informacioni i publikuar duhet të përfshijë sa vijon:

- i. Emrin e sipermarresit dhe adresën e zyrave të tij qendrore.
- ii. Përshkrim të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun që ai ofron.
- iii. Procedurën që ndjek një Pajtimtar për paraqitjen e aplikimit për ofrimin e shërbimeve.
- iv. Nëse ka tarifa të lidhjes dhe/ose pagese periodike, përshkrim të shërbimeve që përfshihen (p.sh. shfrytëzim të shërbimeve të sipermarresit, numëror telefonik, shërbime të informacionit, faturim i detajuar, mirëmbajtje, etj.).
- v. Tarifën standarde që mbulojnë aksesin, gjithë tipet e pagesave të përdorimit dhe mirëmbajtjes, duke përfshirë detaje rreth uljeve të zakonshme ekzistuese dhe synimet speciale të skemave të tarifimit. Duhet përfshirë një përshkrim i mjaftueshëm i cmimeve individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse për tipin e rrjetit, destinacionin dhe zgjatjen e çdo thirrjeje. Përveç kësaj, duhet të ketë një përshkrim të qartë të niveleve të tarifimit, nëse ka të tilla. Neqoftese tarifën janë modifikuar në mënyrë të njohshme, duhet të jepet një përshkrim i qartë i modifikimit të bërë, dhe Përdoruesve u duhet krijuar mundësia të kundërshtojnë këto modifikime dhe të përfundojnë kontratën pa asnjë kosto.
- vi. Politiken e kompensimit/c'dëmtimit, duke përfshirë detaje të sistemit të kompensimit/c'dëmtimit.
- vii. Tipet e shërbimeve të mirëmbajtjes që ofron, duke përfshirë afatin kohor të lidhjes së shërbimeve që ofron ose riparimin e difekteve.
- viii. Cilesinë e shërbimeve të ofruara.
- ix. Kushtet standarde kontraktuale, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, zgjatjen minimale të kontratës.
- x. Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe rregullimin e llogarive.

b) Informacioni i mesipërm duhet publikuar si vijon:

- i. Duke i dërguar informacionin e mësipërm, dhe në mënyrë të vecantë cdo tekst te kontrates se zbatueshme apo pjese te saj, cdo Përdoruesi Fundor që paraqet një kërkesë.
- ii. Duke vendosur informacionin e mësipërm në faqen elektronike të sipërmarrësit, ose nëqoftese kjo faqe nuk ekziston, duke e bërë materialin e mësipërm të disponueshëm për cdo palë të interesuar pa pagesë në zyrat qendrore te sipërmarrësit.
- iii. Në mënyrë më specifike, cdo sipërmarrës është i detyruar te japë gjithë informacionin që lidhet me tarifën në cdo pikë shitjesh të shërbimeve ose të verë në funksionim një qëndër telefonike që jep informacion mbi tarifën.

Detyrimet e mësipërme nuk zbatohen ndaj shërbimeve telefonike që ofrohen nëpërmjet telefonave publikë.

3.1.10. Portabiliteti i numërave

Cdo sipërmarrës i shërbimit publik telefonik është i detyruar të sigurojë portabilitetin e numërave në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9918 dhe vendimeve të AKEP-it.

3.1.11. Numërat jo gjeografikë

Nëqoftese një sipërmarrësi të shërbimit publik telefonik i janë caktuar numra jo gjeografikë nga Plani kombëtar i Numeracionit, ky i fundit duhet të sigurojë, kur është teknikisht dhe financiarisht e mundur, që gjithë përdoruesit fundorë të kenë akses në këto numra.

3.2. Detyrime Shtesë lidhur me Ofrimin e Shërbimeve Publike Telefonike në zona fikse

Dispozitat e mëposhtme kanë të bëjnë me detyrime shtesë që ju vendosen sipërmarrësve që ofrojnë shërbime publike telefonike në zona fikse. Kështu, cdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron Shërbime Publike Telefonike në zona fikse është i detyruar të zbatojë këto dispozita.

3.2.1. Ofrimin e Telefonisë zanore fikse nga ofruesit virtualë

- a) Ofrues virtual (OV) është një sipërmarrës që, megjithëse nuk ka infrastrukturën e tij të komunikimeve elektronike, ofron shërbime të komunikimeve elektronike nën emrin e tij tregtar bazuar në infrastrukturën e sipërmarrësve të tjerë që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të bazuara në kontratat respektive me ta.
- b) Në rastin e Ofruesve Virtualë të Shërbimeve Publike Telefonike në zona fikse, në mënyrë që të sigurohet ofrim i vazhdueshëm i shërbimeve, ata duhet të kenë arritur të paktën dy kontrata bashkëpunimi me sipërmarrësit që ofrojnë Shërbime Publike Telefonike në zona fikse nëpërmjet Rrjeteve të këtyre sipërmarrësve.

3.3. Detyrime lidhur me Ofrimin e Numeratorit Telefonik

- a) Dispozitat e kësaj pike kanë të bëjnë me detyrime shtesë që ju vendosen sipërmarrësve që ofrojnë Numeratorët Telefonikë. Ofrimi i shërbimeve të

informacionit duhet të bëhet gjithmonë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9918 dhe vendimet që mund të marrë AKEP në bazë të këtij ligji, si dhe në dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit.

- b) Ofruesit e Numeratorëve Telefonikë janë të detyruar të firmosin marrëveshje konfidencialiteti me ofruesit e shërbimit publik telefonik që caktojnë numra për pajtimtarët dhe nuk kanë të drejtë të përdorin të dhënat që ju vihen në dispozicion për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat u janë dhënë dhe në vecanti për përfitime të tyre ose për përfitime të pajtimtarëve të tyre ose Kompanive të tjera që bashkëpunojnë me ta.
- c) Ofruesit e shërbimeve të kerkimit të informacionit në Numeratorin Telefonik janë të detyruar të pajisin përdoruesit e tyre me informacionin e mjaftueshëm mbi tarifën për thirrjet drejt kodeve të shkurtra të shërbimeve të kerkimit të të dhënave në Numeratorin Telefonik. Përpara fillimit të shërbimit, me fillimin e thirrjes, ata janë të detyruar të ofrojnë nëpërmjet një mesazhi të regjistruar, pa pagesë për përdoruesit, një përshkrim të qartë të tarifës që aplikohet dhe në mënyrë të vecantë, në varësi të rastit, nëse shuma totale e pagesës nuk varet nga zgjatja e thirrjes, apo vlerën për njësi kohe së bashku me vlerën rezultuese të pagesës për minutë.
- d) Nëse sigurohet realizimi i thirrjes, ofruesit e shërbimeve të kerkimit të informacionit në Numeratorin Telefonik janë të detyruar t'u sigurojnë përdoruesve informacion të mjaftueshëm mbi tarifën që aplikohet për thirrjet, përpara se ata të marrin miratimin e përdoruesve për realizimin e thirrjes dhe të procedojnë me kryerjen e lidhjes.
- e) Në mënyrë më specifike, gjatë reklamimit të shërbimeve promovionale, tarifën duhet të përshkruhen qartë në përputhje me sa më sipër me mesazh të regjistruar. Në rastin e reklamave televizive ose multimediale, tarifën duhet shkruar gjatë gjithë kohës që zgjat reklama në një pozicion fikse dhe jo si një shirit i lëvizshëm.
- f) Ofruesit e shërbimeve të kerkimit të informacionit në Numeratorin Telefonik janë të detyruar t'ju japin përdoruesve informacion të mjaftueshëm dhe të qartë lidhur me shërbimet që ata ofrojnë.
- g) Shërbimi i kerkimit të informacionit në Numeratorin Telefonik mund të përfshijë forma të reja të kerkimit të të dhënave. Disa shërbime treguese mund të perfundojnë thirrjen duke vendosur udhëzues konvencional dhe të dhëna në numërorin telefonik të renditura sipas kategorive, p.sh. sipas kategorive profesionale – në këtë mënyrë një përdorues mund të marrë numrat e të gjithë kompanive që kanë të njëjtin aktivitet duke vendosur numrin e vetëm një kompanie të kësaj fushe, apo ofrimi i shërbimit të informacionit në gjuhë të ndryshme për turistët dhe emigrantët, dhe ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar, si p.sh. informacion mbi numrat e kinemave bazuar në listën e filmave.
- h) Ofrimi i një shërbimi të kerkimit të informacionit ndërkombëtar në Numeratorin Telefonik duhet bërë duke përdorur një kod të shkurtuar të ndryshëm nga ai që

përdoret për shërbimin e kerkimit te informacionit kombëtar ne Numeratorin Telefonik.

- i) Në rastin e shërbimeve te kerkimit te informacionit ndërkombëtar ne Numeratorin Telefonik nuk është e nevojshme të mbulohen të gjitha vendet, sidoqoftë cdo njoftim apo reklamim lidhur me shërbimet në fjalë duhet të specifikojë qartë se kujt vendi i përket.
- j) Ofruesit e shërbimeve të kerkimit te informacionit ne Numeratorin Telefonik janë të detyruar, në reklamimin e shërbimeve të tyre, të specifikojnë nëse shërbimi i ofruar është i plotë dhe të tregojë qartë tipet e numrave të mbuluar nga shërbimi i ofruar.
- k) Personit që thërret me kodin e shkurtuar të shërbimit të kerkimit te informacionit ne Numeratorin Telefonik nuk duhet t'i ofrohet informacion nëqoftëse ky i fundit nuk jep detajet e mjaftueshme rreth emrit dhe/ose adresës të tij.
- l) Ofruesit e shërbimeve të kerkimit te informacionit ne Numeratorin Telefonik janë të detyruar të bëjnë funksionale një linjë ankesash, pa asnjë tarifë shtesë, e cila i takon njoftimeve – reklamave që lidhen me shërbimin në fjalë.
- m) Ofrimi i shërbimeve të kerkimit te informacionit ne Numeratorin Telefonik duhet të respektojë gjithnjë dispozitat e aplikueshme ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretit në sektorin e komunikimeve elektronike.

3.4. Detyrime lidhur me vendosjen e telefonave publikë

- a) Dispozitat e mëposhtme i përkasin detyrimeve shtesë që u vendosen sipërmarrësve që ofrojnë telefona publikë. Kështu, cdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe vendos telefona publikë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme.
- b) Për qëllim të këtij paragrafi, telefonat publikë janë ata që janë instaluar në mënyrë te perhershme në vende publike ku aksesit është i mundur 24 orë.
- c) Cdo sipërmarrës që ofron telefona publikë duhet të sigurojë mundësinë e thirrjes së numrave të emergjencës pa pagesë.

Sipërmarrësi është përgjegjës për instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e këtyre telefonave.

Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë shërbime telefonike dhe, në mënyrë të vecantë, shërbimet vijuese:

- i. Akses në numeratorët telefonikë në mënyrë të tillë që gjithë shërbimet e informacionit që ofrohen nëpërmjet serive 118XX të mundësohen nga të gjithë telefonat publikë, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur.

- ii. Akses pa pagesë në shërbimet e emergjencës pa përdorim karte apo monedhe.
 - iii. Akses në shërbimet e postës zanore.
- d) Sipërmarrësit janë të detyruar të tregojnë informacionin vijues, në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe lehtësisht të dallueshme, në zonën ku janë instaluar telefonat:
- i. Informacion mbi pagesat e bëra dhe mënyrat e e pagimit për shërbimet në fjalë. Duhet të ketë një informim të mjaftueshëm dhe të qartë për cmimet individuale që zbatohen për destinacionin dhe kohën kur është bërë thirrja. Përvec kësaj, duhet të ketë informim të qartë mbi nivelin e tarifimit dhe tarifën minimale.
 - ii. Duhet të tregohet mundësia e kryerjes së thirrjeve të emergjencës.
 - iii. Duhet të tregohet mundësia e marrjes të thirrjeve hyrëse.
 - iv. Numri i kontaktit nëse ka ankesa ose probleme.
- e) Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë që 75% e telefonave publikë të jenë të aksesueshëm nga personat që përdorin karrike me rrota.
- f) Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të konsultohet me AKEP mbi specifikimet e telefonave publikë që ai ka ndërmend të instalojë, në mënyrë që të sigurojë që çështjet lidhur me personat me aftësi të kufizuara të merren në konsideratë në instalimin dhe ofrimin e telefonave publikë.

3.5. Detyrime lidhur me ofrimin e shërbimeve të informacionit multimedialë

Dispozitat e mëposhtme i takojnë detyrimeve shtesë që u vendosen sipërmarrësve që ofrojnë Shërbime të Informimit Multimedialë. Ky shërbim përfshin Audiotekstin dhe Videotekstin, mesazhet e shkurtër me vlerë të shtuar (SMS) dhe mesazhet multimedialë me vlerë të shtuar (MMS). Kështu, çdo sipërmarrës që punon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron shërbime informimi multimedialë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme:

